



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 165/2 Prot.

Vlorë, më 29. 01. 2021

VENDIM

Nr. 3, datë 26. 01. 2021

PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT PËR TË
GJITHA CIKLET E STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2022- 2023

Mbështetur në nenin 38, nenin 74, 76, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 19 pika 1 gërma f, të Statutit të Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen online të datës 26. 01. 2021

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret e pranimit në programet e studimit për të gjitha ciklet për vitin akademik 2022- 2023, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kriteret e miratuara i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI



KRITERET 2022-2023 UV

IFAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

1) Departamenti e Shkencave Kompjuterike

Për vitin akademik 2022-2023 pranimi i studentëve në të gjitha programet e ciklit të parë të ofruara nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike :

- **Bachelor në Informatikë,**
- **Bachelor në Teknologji Informacioni**
- **Bachelor në Shkenca Kompjuterike**

do të bëhet duke renditur maturantët kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme.

Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën **Informatikë** në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme.

- **Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”.**

Titujt e studimit që duhen patur parasysh për pranimin sipas preferencës.

1. Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Shkenca Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.
2. Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët e Shkencave Kompjuterike, Inxhinierisë Elektronike, si dhe Inxhinieri të tjera të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
3. Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët e Shkencave Kompjuterike të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
4. Do të pranohet të njihen të gjitha diplomat Bachelor Dega Informatikë Ekonomike dhe Bachelor ne Ekonomi.
5. Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë, Fakulteti i Shkencave Teknike Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.
6. Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët e Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë, dhe Inxhinieri të tjera të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.

7. Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët e Inxhinieri Elektrike, Matematikë, Matematikë-Fizikë, dhe Inxhinieri të tjera të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.

Studentët fitues në këto programe do të përzgjidhen mbi bazën e mesatares së arritur në studimet e ciklit të parë (bachelor) sipas parimit të meritës dhe kërkesës së aplikantit.

- **Master Profesional “Mësuesi për Arsimin e Mesëm në Lëndën Informatikë”.**

Titujt e studimit që duhen patur parasysh për pranimin sipas preferencës.

1. Bachelor në Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Shkenca Kompjucionale, Fakulteti i Shkencave Teknike Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.
2. Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët e Shkencave Kompjuterike të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
3. Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët e Shkencave Kompjuterike të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
4. Do të pranohet të njihen të gjitha diplomat Bachelor Dega Informatikë Ekonomike dhe BCh ne Ekonomi.
5. Bachelor në Matematikë, Matematikë-Fizikë, Fakulteti i Shkencave Teknike Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.
6. Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët Matematikë, Matematikë-Fizikë të shkollave publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.
7. Bachelor të fakulteteve të tjera ne degët Matematikë, Matematikë-Fizikë të shkollave jo publike, vendase e të huaja pasi të jetë bërë njohja e tyre sipas rregullores përkatëse të fakultetit.

Studentët fitues në këto programe do të përzgjidhen mbi bazën e mesatares së arritur në studimet e ciklit të parë (bachelor) sipas parimit të meritës dhe kërkesës së aplikantit.

2. Departamenti i Shkencave detare

Për vitin akademik 2022-2023 pranimi i studentëve në programin e ciklit të parë

- **Bachelor në Navigacion**

Do të bëhet renditja e maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme.

Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Informatikë në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme.

Kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit

- **Master Profesional në Studime të Avancuara Detare**, janë si më poshtë:

1. Kandidatët të jenë diplomuar ne disiplinat e Shkencave Detare ose në fusha të përfaqëta me to, në programet e studimit Bachelor në Drejtësi, Bachelor në fushat e ekonomisë.
2. Përzgjedhja e studentëve do të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.
3. Krite preferenciale gjatë listimit të kandidatëve:
 - a) Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të Studimeve në programet e studimit në FSHT, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.
 - b) Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të Studimeve në IAL publike dhe më pas nga IAL jopublike.
 - c) Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të Parë të Studimeve me diplomën e Ciklit të Dytë për të cilën aplikojnë.

3. Departamenti i Matematikës

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për Ciklin e Parë të studimeve në Departamentin e Matematikës, për vitin akademik 2022-2023 do të jetë si më poshtë:

- **Bachelor në Matematikë**

Renditja e maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme.

Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Matematikë në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për Ciklin e Dytë të studimeve në Departamentin e Matematikës janë si më poshtë:

- **Master Profesional**

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.

Kritere preferenciale

1-Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në IAL-publike, dhe pastaj atyre që vijnë nga IAL-jopublike

2- Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në programet e studimit në FSHT, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.

2. Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të parë të studimeve me diplomën e Ciklit të Dytë për të cilën aplikojnë.

4.Dep.i Biologjise

Departamenti i Biologjisë për vitin akademik 2022-2023 propozon që pranimi i studentëve në të gjitha programet e ciklit të parë të ofruara nga Departamenti i Biologjisë :

- **Bachelor në Biologji,**

Do të bëhet sipas renditjes së maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme e përlogaritur nga Ministria e Arsimit.

Ndër kandidatët me pikë të barabarta në Bachelor në Biologji përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Biologji në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

Kriteret e pranimit të aplikantëve për Ciklin e Dytë të studimeve në Master Profesional “Mësuesi AM në Biologji, me profil minor në Kimi” dhe Master Shkencor në “Biologji Mjedisore” për vitin akademik 2022-2023, përkatësisht si më poshtë:

- **Master Profesional**

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.

Kritere preferenciale

1-Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në IAL-publike, dhe pastaj atyre që vijnë nga IAL-jopublike

2- Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në programet e studimit në Biologji në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.

3. Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të parë të studimeve me diplomën e Ciklit të Dytë për të cilën aplikojnë.

- **Masteri I Shkencave**

1. Përzgjedhja e studentëve të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.

Kritere preferenciale

1-Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në IAL-publike, dhe pastaj atyre që vijnë nga IAL-jopublike.

2- Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në programet e studimit në Biologji, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.

3. Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të parë të studimeve me diplomën e Ciklit të Dytë për të cilën aplikojnë.

5. Departamenti i Kimisë

Departamenti i Kimisë për vitin akademik 2022-2023 propozon që pranimi i studentëve në të gjitha programet e ciklit të parë të ofruara nga Departamenti i Biologjisë:

- **Bachelor në Kimi,**

Do të bëhet sipas renditjes së maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme

Renditja e studentëve do të bëhet sipas rendit zbritës të mesatares së ponderuar të shkollës së mesme.

Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Kimi në tre vitet e studimit në shkollën e mesme.

- **Master Profesional”Mesimdhenie ne kimi per AMU”**

Do të pranohen candidate që kanë të paktën një diplomë në Bachelor në fushën e Kimisë ose Bio-Kimisë.

Përparësi do të kenë kandidatët që kanë diplomë në fushën e studimit Kimi dhe më pas ata Bio-kimi.

Kandidatët do të zgjidhen në bazë të notës mesatare dhe diplomës që zoterojnë.

Kritere shtesë:

Renditja e studentëve do të bëhet sipas rendit zbritës të mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor.

Të preferohen studentët e IAL-ve publike dhe më pas jopublike.

-Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në :

- Bachelor në Kimi
- Bachelor në Bio-Kimi
- Bachelor në Kimi industrial e Mjedisore
- Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore.

- **Masteri Shkencave”mesuesi AML ne KIMI”**

Do të pranohen candidate që kanë të paktën një diplomë Bachelor në fushën Kimi ose Biokimi. Përparësi do të kenë kandidatët që kanë diplomë në fushën e studimit Kimi dhe më pas ata Bio-kimi.

Kandidatët do të zgjidhen në bazë të notës mesatare dhe diplomës që zoterojnë.

Kritere shtesë:

Renditja e studenteve do të bëhet sipas rendit zbritës të mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor

Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në :

- Bachelor në Kimi
- Bachelor në Bio-Kimi
- Bachelor në Kimi industrial e Mjedisore
- Bachelor në Kimi dhe Teknologji Ushqimore.
- **Program 2-vjeçar “Diplome profesionale “Teknik laborator kimik”**

Pranimi I studenteve do të bëhet bazuar në renditjen e maturantëve candidate në bazë të mesatares së shkolles së mesme.

Renditja e studenteve do të bëhet sipas rendit zbritës të mesatares së ponderuar të shkolles së mesme.

Ndër kandidatët me pikë të barabarta përparësi kanë kandidatët me mesatare më të lartë në lëndën Kimi në 3 vitet e shkolles së mesme.

6. Departamenti I Fizikës.

Për vitin akademik 2022-2023 pranimi i studentëve në të gjitha programet e ciklit të parë të ofruara nga Departamenti i Fizikës;

- **Bachelor në Fizikë,**
- **Bachelor në Matematikë-Fizikë**

do të bëhet sipas renditjes së maturantëve kandidatë në bazë të mesatares së Shkollës së Mesme e përlogaritur nga Ministria e Arsimit.

Ndër kandidatët me pikë të barabarta në Bachelor Fizikë përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndën Fizikë në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme.

Ndër kandidatët me pikë të barabarta në Bachelor Matematikë-Fizikë përparësi kanë kandidatët që kanë mesatare më të lartë në lëndët Matematikë dhe Fizikë në tre vitet e studimit në Shkollën e Mesme.

- **“Master i Shkencave në Fizikë”**.

Të drejtë regjistrimi në regjimin e studimeve të ciklit të dytë, sipas modelit 3+2 kanë kandidatët që kanë diplomë universiteti të ciklit të parë, nga studimet trevjeçare (180 ECTS) apo katërvjeçare (240 ECTS), si më poshtë:

Bachelor në Fizikë, Bachelor në Matematikë-Fizikë, Bachelor në programe studimi të cilat kanë mbi 70% mbivendosje me programin studimor për të cilin konkurohet.

Gjuha e huaj, në mbështetje të pikës 4 të nenit 76 të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të udhëzimit Nr. 11, datë 10.04.2017 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë, të ndryshuar “

Renditja e kandidat studentëve do të bëhet duke filluar nga mesatarja më e lartë e diplomës e arritur në studimet e ciklit të parë.

- **“Master Profesional në Mësuesi për CLAB në Lëndët Matematikë-Fizikë”**

Të drejtë regjistrimi në regjimin e studimeve të ciklit të dytë, sipas modelit 3+2 kanë kandidatët që kanë diplomë universiteti të ciklit të parë, nga studimet trevjeçare (180 ECTS kredi) apo katërvjeçare (240 ECTS), si më poshtë:

Bachelor në Fizikë, Bachelor në Matematikë-Fizikë, Bachelor në programe studimi të cilat kanë mbi 70% mbivendosje me programin studimor për të cilin konkurohet.

Renditja e kandidat studentëve do të bëhet duke filluar nga mesatarja më e lartë e diplomës e arritur në studimet e ciklit të parë.

7. Departamentin e Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare,

Programet e studimit të ciklit të parë,

- **Bsc Inxhinieri Navale,**

- **Bsc Inxhinieri Mekanike,**
- **Bsc Inxhinieri Elektrike.**

1. Në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, Bsc Inxhinieri Navale, Bsc Inxhinieri Mekanike, Bsc Inxhinieri Elektrike, të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë renditja sipas mesatares së shkollës së mesme, me nivel mesatar të përcaktuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
2. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare dhe me pikë të njëjta në rankim, si kriter përzgjedhës i rankimit do të merret mesatarja e Matematikës, nëse përsëri do të ketë studentë me pikë të njëjta do të merret mesatarja e Fizikës, dhe nëse edhe pas këtij rankimi do të rezultojnë studentë me mesatare të njëjta si kriter përzgjedhës do të merret mesatarja e Kimisë.

- **Master Profesional - “Master në Operacione Industriale dhe Navale”**

1. Kandidatët të jenë të diplomuar në disipinat e Inxhinierisë Navale, Mekanike, ose në fusha të përafërta me to.
2. Përzgjedhja e studentëve do të bëhet bazuar në kriterin e notës mesatare duke i vendosur në rendin zbritës deri në plotësimin e kuotave të miratuara për diplomën përkatëse.
3. Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë detyrimet sipas Udhëzimit përkatës të Ministrisë së Arsimit Rinisë dhe Sportit.
4. Kritere preferenciale gjatë listimit të kandidatëve:
 - a. Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në IAL^{-të} publike, dhe pastaj atyre që vijnë nga IAL^{-të} jopublike
 - b. Jepet përparësi kandidatëve që kanë përfunduar Ciklin e Parë të studimeve në programet e studimit në FSHT, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë.
 - c. Jepet përparësi studentëve që kanë ngjashmëri të diplomës së Ciklit të parë të studimeve me diplomën e Ciklit të Dytë për të cilën aplikojnë.

II.FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE

Kriteret dhe kuotat e pranimit për programet e studimit të

1.Departmentit të Gjuhëve të Huaja për vitin akademik 2022-2023.

- a) Për programin e studimit **“Bachelor në gjuhë angleze”**, kriteret të jenë si vijon:
- Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.
- b) Për programin e studimit **“Bachelor në gjuhë italiane”**, kriteret të jenë si vijon:
- Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.
- c) **“Master profesional në mësuesi për CLAB në lëndën gjuhë angleze” dhe “Master profesional në mësuesi për CLAB në lëndën gjuhë italiane”**
- Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në Departamentin e Gjuhëve të Huaja, kandidatët që:
 1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë “Bachelor” në gjuhë të huaj.
 2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në gjuhë të huaj dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
 3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
 4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.
- d) **“Master i shkencave në përkthim dhe interpretim”**

- Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” në Departamentin e Gjuhëve të Huaja, kandidatët që:
 1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë “Bachelor” në gjuhë të huaj.
 2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në gjuhë të huaj dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
 3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
 4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

2. Departamentin e Drejtësisë

Kriteret për pranimin e studentëve të rinj në vitin akademik 2022-2023 në Programin e integruar të ciklit të dytë në **Drejtësi**

Pranimi i studentëve të rinj në vitin akademik 2022-2023, të kryhet 100% në bazë të mesatares së të gjithë viteve të studimeve në ciklin e mesëm dhe mesatares së provimit të maturës.

Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve **Master shkencor në «Marrëdhënie ndërkombëtare» dhe Master profesional në «E drejtë penale» dhe në «Shkenca administrative»**, në Departamentin e Drejtësisë, kandidatët që:

1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë Bachelor në «Drejtësi» ose fusha të përafërta.
2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në «Drejtësi» ose fusha të përafërta dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR.

3. (vetëm për aplikantët në programin e studimeve **Master shkencor**): përmbushin detyrimin e njohjes së gjuhës së huaj të parashikuar nga neni 76, pika 4 e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës së notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.

Do të kenë përparësi kandidatët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në drejtësi pranë UIQV-së, si dhe kandidatët e diplomuar pranë Akademisë së Sigurisë dhe Hetimit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë.

3. Departamenti i Gjuhës shqipe dhe letrisë

Ne **Bachelor ne Gjuhe shqipe** dhe letërsi kriter pranimi do te jete :

Nota mesatare e 3 viteve te studimit dhe e provimeve te matures shtetore qe do te kete 100% te vleresimit ne renditje.

Ne programin “**MS ne mesimdhenie e Gjuhes Shqipe dhe letrisë**”:

Kane te drejte te aplikojne kandidatet qe kane perfunduar studimet ne Bachelor ne Gjuhe shqipe dhe letrisë.

Jane diplomuar jashte vendit ne nje program Bachelor ose Program te integruar te Cilit II ne Gjuhe shqipe dhe Letërsi dhe kane njesuar diplomen ne MASR.

Renditja do te behet sipas rendit ybrites te mesatares deri ne plotesimin e kuotave.

Preferohen kandidate qe kane perfunduar ciklin e pare te studimeve prane UV.

4. Departamenti i Edukimit:

a) Për programin e studimit **“Bachelor në Mësuesi për Arsmin Fillor”, “Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, “Bachelor në Pedagogji e Specializuar”, “Bachelor në Histori-Gjeografi”**, kriteret të jenë si vijon:

- Nota mesatare e tri viteve të studimit dhe e provimeve të maturës shtetërore të ketë 100% të vlerësimit në renditje.

b) **“Master profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor kl I-V”**

- Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në Departamentin e Edukimit, kandidatët që janë të pajisur me një diplomë në “Bachelor në Mësuesi për Arsmin Fillor”, “Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor” dhe dege të përafërta me këtë drejtim:
 1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë si më lartë.
 2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” në programet e mësipërme dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
 3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
 4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

c) **“Master i shkencave në Edukim”,**

- Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave në Edukim” në Departamentin e Edukimit, kandidatët që:
 1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë “Bachelor” në arsimin fillor, parashkollor dhe fusha të tjera studimi .
 2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
 3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
 4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

d) **“Master i shkencave në Pedagogji e Specializuar Sociale”**

- Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave Pedagogji e specializuar sociale” në Departamentin e Edukimit, kandidatët që:
 1. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë “Bachelor” në pedagogji e specializuar, arsimin fillor, parashkollor dhe fusha të tjera studimi të përafërta.
 2. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
 3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
 4. Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së

III.FAKULTETI I EKONOMISE

1. Departamenti I Finances.

Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në **Bachelor në “Financë”** dhe **Bachelor në “Kontabilitet”** që ofron Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit , kriteret e pranimit të studentëve në këtë cikël të parë të studimit, të jenë:

1. Kriteret e parashikuara sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 74 pika 1, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve”, ku cilësohet:

“Pranimi në programet e ciklit të parë të studimit është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”.
2. Nota Mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore të këtyre 100% të vlerësimit në renditje.
 1. Kriteria shtesë të pranimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë "Master Profesional" dhe “Master i Shkencave”, për vitin akademik 2022-2023, si më poshtë:

1.1. Programet e studimit “Master Profesional”

- a. Në programet e studimit **Master i Shkencave në “Financë”** në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi me mesatare jo me pak se 6.5.
- b. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit Finance, Kontabilitet, Aktuaristike, Matematike-Finance që do të renditen sipas mesatares dhe ne vazhdim studentet që kane diplome Bachelor ne ekonomi dhe ne fund ata që vijne nga programe te tjera studimi.
- c. Në programet e studimit **Master i Shkencave në “Pasuritë e Paluajtshme”** në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi. Përparësi do të kenë kandidatët që zotërojnë një diploma në fushën e Finance, Kontabilitet, Aktuaristike, Matematike-Finance, Arkitekture, Inxh. Ndertimi që do të renditen sipas mesatares dhe ne vazhdim studentet që zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë. Pas tyre po sipas mesatares studentet e programeve të tjera.

2. Departamenti I Biznesit.

Kriteret e pranimit të kandidatëve që aplikojnë në programet e ciklit të parë të studimit për vitin akademik 2022-2023, Departamenti i Biznesit propozon:

1. Për programin e studimit të ciklit të parë **Bachelor në “Administrim Biznesi”, Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, Bachelor në “Marketing”** që ofron Departamenti i Biznesit, kriteret e pranimit të studentëve në këtë cikël të parë të studimit, të jenë:

Kriteret e parashikuara sipas Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 74 pika 1, “Pranimi në ciklin e parë të studimeve”, ku cilësohet:

“Pranimi në programet e ciklit të parë të studimit është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Nota Mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore.

2. Kriteria shtesë të pranimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë "**Master Profesional**" dhe "**Master i Shkencave**", për vitin akademik 2022-2023, si më poshtë:

Programet e studimit "Master Profesional"

- Në programet e studimit **Master i Profesional në "Administrim Publik"** në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatët të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës, më pas do të renditen kandidatët të cilët zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë, dhe në fund kandidatët që zotërojnë një diplomë në fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.
- Në programet e studimit **Master Profesional në "Marketing"** në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatët të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës, më pas do të renditen kandidatët të cilët zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë, dhe në fund kandidatët që zotërojnë një diplomë në fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.
- Në programet e studimit **Master i Profesional në "Sipërmarrje në Turizëm"** në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatët të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi. Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë në fushën e studimit të programit përkatës, më pas do të renditen kandidatët të cilët zotërojnë një diplomë Bachelor në fushën e ekonomisë, dhe në fund kandidatët që zotërojnë një diplomë në fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.

3. Programet e studimit "Master i Shkencave"

- Në programet e studimit **Master i Shkencave në "Administrim Biznesi"** në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi. Kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notes mesatare dhe diplomës që zotëron.

3. Departamenti i Ekonomiksit,

Ne **Bachelor në Ekonomiks**, kriteret e pranimit të studentëve në këtë cikël të jenë:

- Kriteret e parashikuara sipas Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 74 pika 1, "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", ku cilësohet: *"Pranimi në programet e ciklit të parë të studimit është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave"*.
- Nota Mesatare e përgjithshme në tre vitet e studimit duke përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore.

Programi i studimit **Master i Profesional “Ekonomiks në Sipërmarrje”**:

Në programet e studimit Master i Profesional në “Ekonomiksi ne Sipermarrje” në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në fushën e ekonomisë apo fusha të tjera studimi.

- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë Bachelor në degën e Ekonomiksit pranë Fakultetit të Ekonomisë Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, pastaj në fushën e Ekonomisë që kanë përfunduar pranë Fakultetit të Ekonomisë Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, renditur sipas mesatares.
- Më tej kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.

1.3. Programet e studimit "**Master i Shkencave në “Ekonomiks”**

Në programet e studimit Master i Shkencave në “Ekonomiks” në Fakultetin e Ekonomisë do të pranohen kandidatë të cilët zotërojnë të paktën një diplomë "Bachelor" në ekonomi, apo dhe fusha të tjera studimi, me notë mesatare të përcaktuar nga MAS.

- Përparësi do të kenë kandidatët të cilët zotërojnë diplomë Bachelor në degën e Ekonomiksit pranë Fakultetit të Ekonomisë Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, pastaj në fushën e Ekonomisë që kanë përfunduar pranë Fakultetit të Ekonomisë Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, renditur sipas mesatares.
- Më tej kandidatët do të përzgjidhen mbi bazën e notës mesatare dhe diplomës që zotëron.

4. FAKULTETI I SHENDETTIT

Kriteret e pranimit për programin e studimit **Bachelor në Infermieri të Përgjithshme** për vitin akademik 2022-2023 të jenë si më poshtë:

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë mesatarja e përgjithshme e shkollës së mesme, me nivel minimal të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e llogaritur nga QSHA sipas rendit zbritës.
2. Kandidatët do të renditen në rend zbritës sipas mesatares së shkollës së mesme të përlogaritur nga QSHA.
3. Në rast se do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Biologjisë.
4. Në rast se sërish do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas mesatares së 3 (tre) viteve të lëndës së Kimisë.

➤ Për Master Profesional në Infermieri Patologjike dhe Kirurgjikale:

1. MP në Infermieri Patologjike dhe Kirurgjikale pranohen kandidatët që zotërojnë diploma e mëposhtme:
 - Diplomë Bachelor në Infermieri të përgjithshme
 - Diplomë Bachelor në Mami Infermier
 - Diplomë Bachelor në Infermieri në Shëndet Publik
 - Diplomë Bachelor në Teknik Laboratori
 - Diplomë Bachelor në Fizioterapi
 - Diplomë Bachelor në Teknik Radiolog
 - Diplomë Bachelor në Higjienist Dentar
 - Diplomë të sistemit të vjetër: Infermier i përgjithshëm

të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha Fakultetet apo Shkollat e Larta të Infermierisë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Përzgjedhja e kandidatëve në Masterin Profesional në Infermieri Patologjike dhe Infermieri Kirurgjikale do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të tyre

në ciklin e parë të studimeve. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare Bsc në fund të listës, renditjen do ta përcaktojë lëndët specifike: MP Infermieri Patologjike do të jenë modulet e lëndëve Sëmundje e Brendëshme, MP Infermieri Kirurgjikale do të jetë moduli i lëndës Bazat e Kirurgjisë. Nëse do të ketë përsëri studentë me të njëjtën mesatare Bsc në fund të listës, pas mesatares me lëndët specifike, renditjen për të dy masterat do ta përcaktojë moduli i lëndës Infermieri Speciale për Adultin.

3. Politika përzgjedhëse e kandidatëve do të jetë si më poshtë:

- Studentët që kanë kryer studimet në UV.
- Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.
- Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë

➤ **Për master Shkencor në Shkenca Infermierore pranohen kandidatët që:**

1. Zotërojnë këto diploma :

- Diplomë Bachelor në Infermieri të përgjithshme
- Diplomë Bachelor në Mami Infermier
- Diplomë Bachelor në Infermieri në Shëndet Publik
- Diplomë Bachelor në Teknik Laboratori
- Diplomë Bachelor në Fizioterapi
- Diplomë Bachelor në Teknik Radiolog
- Diplomë Bachelor në Higjenist Dentar
- Diplomë të sistemit të vjetër: Infermier i Përgjithshëm

të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha Fakultetet apo Shkollat e Larta të Infermierisë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Përzgjedhja e kandidatëve në **Masterin Shkencor në Shkenca Infermierore** do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të tyre në ciklin e parë të studimeve. Mesatarja e diplomës së marrë në ciklin e parë të studimeve duhet të jetë ≥ 7

3. Politika përzgjedhëse e kandidatëve të jetë si më poshtë:

- Studentët që kanë kryer studimet në UV.
- Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.
- Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë

Kriteret e pranimit për programin studimit **Bachelor në Infermieri Mami** për Vitin Akademik 2022-2023 të jenë si më poshtë:

1. Kriteri përzgjedhës me 100% të pikëve do të jetë mesatarja e shkollës së mesme, me nivel minimal të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, e llogaritur nga QSHA sipas rendit zbritës.
2. Nëse do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas msatares së 3 (tre) viteve të lëndës Biologji.
3. Nëse sërisht do të ketë kandidatë me pikë të barabarta, renditja do të bëhet në rend zbritës sipas msatares së 3 (tre) viteve të lëndës Kimi.

“Kriteret e pranimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve në programet akademike të Departamentit të Kujdesit Shëndetësor për vitin akademik 2022-2023” dhe vendosi këto kritere:

➤ **Për Master Profesional në Infermieri Pediatrike:**

4. MP në Infermieri Pediatrike pranohen kandidatët që zotërojnë diploma e mëposhtme:
 - Diplomë Bachelor në Infermieri të përgjithshme
 - Diplomë Bachelor në Mami Infermier
 - Diplomë Bachelor në Infermieri në Shëndet Publik
 - Diplomë Bachelor në Teknik Laboratori
 - Diplomë Bachelor në Fizioterapi
 - Diplomë të sistemit të vjetër: Infermier i përgjithshëm

Të fituara në përfundim të ciklit të parë të studimeve në të gjitha Fakultetet apo Shkollat e Larta të Infermierisë Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

1. Përzgjedhja e kandidatëve në Masterin Profesional në Infermieri Pediatrike do të bëhet në bazë të rendit zbritës të mesatares së ponderuar të notave të tyre në ciklin e parë të

studimeve. Nëse do të ketë studentë me të njëjtën mesatare Bsc në fund të listës, renditjen do ta përcaktojë nota e lëndës “Pediatri”. Nëse edhe sipas këtij kriteri do të kemi barazim pikësh, renditja do të bëhet sipas notës së marrë në modulin “Kujdesi për nënën dhe fëmijën”.

2. Politika përzgjedhëse e kandidatëve të jetë si më poshtë:

- Studentët që kanë kryer studimet në UV.
- Studentët që kanë kryer studimet në Institucione Publike të Arsimit të Lartë.
- Studentët që kanë kryer studime në Institucione Private të Arsimit të Lartë